

NE GJYKATEN KOMUNALE TE PRIZRENIT
Numri i Rasitit PPS 34/09
16 Tetor 2009

NE EMER TE POPULLIT

Gjyqtari Malcolm Simmons si kryetar i trupit gjykues, me procesmbajtësit Viora Johnston, Valentina Gashi, Stephen Parkinson, Nexhmije Mezini, Patricia Faltusova dhe Sonila MacNeil, ne rastin penal kunder te pandehurit 1) Enver Zhitia, 2) Gani Grajqevci dhe 3) Selman Bogiqi, te denuar konform propozimit te aktakuzes te ngritur nga zyra e Prokurorisë Speciale te Republikës se Kosoves (ne vazhdim si SPRK) te dates 12 Maj 2009 me vepren penale te "Zbulim i Sekreteve Zyrtare" te kryer ne periudhe kohore te 13 Gushtit deri ne 24 Gusht 2007, 3 Shtator 2007 dhe me 7 Prill 2008 ne komunën e Prishtinës, Kosove, ne kundërshtim me nenin 347(1) te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves (ne vazhdim si KPPK-ja),mbas mbajtjes se shqyrtimeve publike me 20 Korrik, 1, 2, 16, 23 Shtator dhe 8 Tetor 2009, Nazmi Mustafa ishte ne cilesin e Prokurorit Special te Republikës se Kosoves, i pandehuri i pare Enver Zhitia ishte perfaqesuar nga Mexhid Sylja, i pandehuri i dyte Gani Grajqevci e perfaqesoi vetveten dh ei pandehuri i trete Selman Bogiqi, ishte perfaqesuar nga Bajram Tmava, me 16 Tetor 2009 trupi gjykues muar dhe shpalli si ne vijim:


AKTGJYKIM

I pandehuri **Gani GRAJQEVCI**, i biri i Sadik Grajqevci dhe Fatime Haliti, i lindur me 8 Shkurt 1952 ne fshatin Ribar i Madhe ne komune te Lipjanit, tani me banim ne rrugen "Ibrahim Oruçi"nr. 349 ne Prishtine, me numer te karteles identifikuese 1011127548, i martuar, bab i tre femijeve, nenpunës civil administrativ ne Gjykatën e Qarkut te Prishtinës,Shqiptar Kosovar, te kryer shkollen e mesme, me gjendje te mire ekonomike.

Konform nenit 389 (1) te KPPK-se

AKUZA REFUZOHET

Se me 13 dhe 17 Gusht 2007 ne cilesin e nenpunesit administrativ te zyles se regjistrimit ne Gjykatën e Qarkut te Prishtinës, duke vijuar ne baze te shenimeve te procedures se hetimeve ai; si person per gjegjes ne prezenc te kolegut te tij, te pandehurit te pare Enver Zhitia pa



autorizim i komunikoi dhe ia mundesoi informaten nje personi te paautorizuar Rexhep Ibishit lidhur me detaje te procedures hetimore, informata te cilat kane perber nje sekret zyrtar, zbulimi i te cilit ka shkakuar apo kiste per te shkakuar pasojat te demshme. Me vone me 20 Gusht 2007 Me vone me 20 Gusht 2007 ai komunikoi informta te njejta personit te quajtur Flamur Bogaj, ku ai kiste penguar zhvillimin normal te procedures penale. Per kete arsye eshte supozuar qe ai ka kryer vepren penale te "zbulimit te sekreteve zyrtare" ne kundershtrim me nenin 347 (1) te KPPK-se.


Ne vazhdim, I pandehuri **Enver Zhita**, i biri i Hetem Zhitas dhe Zyfyje Shabani, Shqiptar Kosovar, i lindur me 15 Prill 1952 ne fshatin Lluqe, komunen e Podujeves, tani me banim ne rrugen " Nazmi Gafurri" nr. 245, ne Prishtine, me numer te karteles identifikuese 10001225096, i martuar, baba i 6 femijeve, koheve te fundit duke punuar si arketar ne Gjykaten e Qarkut ne Prishtine, Shqiptar Kosovar, te kryer fakultetin Juridik, gjendje te mesme ekonomike.

I pandehuri **Selman Bogiqi**, i biri i Fetah Bogiqi dhe Kada Morina, i lindur me 6 Dhjetor 1949 ne Komoran, komuna e Gllgovcit, tani me banim ne rrugen "Xhemaj Mustafa" ne Prishtine, me numer te karteles identifikuese 101450573, i martuar, Gjyqtar i Gjykates se Qarkut ne Prishtine, Shqiptar Kosovar, te kryer fakultetin Juridik, me gjendje te mesatare ekonomike.

Konform nenit 390 alineja 1 te KPPK-se;

LIROHEN NGA AKUZAT

Se i pandehuri i pare Enver Zhita me 13 dhe 14 Gusht 2007, ne clesin e zyrtarit te Gjykates se Qarkut ne Prishtine, dhe mbas diksutimit paraprak me Rexhep Ibishin lidhur me procedura hetimore te inicuar ne baze te Aktvendimit 58/07 te dates 26 Korrik 2007 nga Prokuroria Speciale e Republikes se Kosoves kunder te pandehurit Gani Rukiqi, Drita Rucqiq dhe Nerxhivane Daka per kryerje te vePRES penale te "keqperdorimit te detyres zyrtare apo pozites"ne kundershtrim me nenin 339 te KPPK-se dhe "marjia e rryshfetit" ne kundershtrim me nenin 343 te lidhur me nenin 20 dhe 23 te KPPK-se, shkoi ne shkrimore te gjykates dhe kishite kontrolluar dosjen e rasisit, dhe mbas ketij kontrolli te pa autorizuar, nepërmjet bisedes telefonike ku ai e kishite me te pandehurin Gani Rukiqi me 14 Gusht 2007 ne prezenc te Rexhep Ibishit, ku kane komunikuar dhe ia mundesoi atij informata lidhur me inicimin e procedures hetimore. Keto informata perberin nje sekret zyrtar, zbulimi i te cilit ka shkakuar



apo mund te kishte shkaktuar pasojat te demshme. Prandaj me keqe veprim ai ka penguar zhvillimin normal te procedures penale.

I pandehuri i trete Selman BOGOLJ ne cilesin e personit zyrtar, duke vepruar si gjyqtar i procedures paraprake te Gjykates se Qarkut te Prishtines ne procedure penale te lartcekur te inicuar kunder te pandehurve Gani Rukiqi, Drita Rukiqi dhe Nerxhivane Daka si inspektor te ndertimitarise ne komunen e Prishtines, per vepren penale te lartcekur ne baze te aktvendimit 58/07 te dates 26 Korrik 2007, me qellim dhe pa autorizim, nepermjet bisedave telefonike me te pandehurin Gani Rukiqin kane komunikuar dhe ia mundesun atij informata detajlike lidhur me procedurat hetimore te lartcekudara te inicuarra kunder tij, informata te cilat perbenin sekret zyrtar, zbulimi i te cilit ka shkaktuar apo mund te shkaktonte pasoja te demshme.

Si rriedhoj, i pandehuri Selman Bogolji ka demtuar proceduren penale kunder te pandehurin Gani Rukiqi, Drita Rukiqi dhe Nerxhivane Daka, te cilat ishin te dyshuar per marjen e rryshfetit nga pala e demtuar, domethen inicues te kallximit penal, Agim Kryeziu, qytetar i Prishtines.

Nga kjo arsye eshte supozuar se i pandehuri i trete kishte kryer vepren penale te "zbulimi i sekreteve zyrtare"ne kundershtrim me nenin 347 alineja 1 te KPPK-se.


Konform nenit 103 te KPPK-se shpenzimet e procedures penale nen nenin 99 alineja 2, nen alineja 1 deri 5, shpenzimet e nevojshme te te pandehurit dhe pagesat si dhe shpenzimet e avokatit mbrojtës duhet te paguhen nga burimet buxhetore.

ARSYETIM

Ishte rasti i prokurorise inter alia, qe informatat apo dokumentet te mbajtura brenda dosjes se gjykates te shenuara me "SEC", rasti ishte nje "sekret zyrtar" ne kuptim te nenit 347 te KPPK-se.

Rasti i prokurorise kunder secilit te pandehur thekson si ne vijim:

I pandehuri i pare, Enver ZHITIA




Me 13 dhe 14 Gusht 2007, ne cilesin e zyrtarit te Gjykates se Qarkut ne Prishtine, dhe mbas diksutimit paraprak qe ai kishite personalisht me Rexhep Ibishin lidhur me procedura hetimore te inicuar ne baze te Aktvendimit 58/07 te dates 26 Korrik 2007 nga Zyra e Prokuroris Speciale e Republikes se Kosoves kunder te pandehurit Gani Rukiqi, Drita Ruqkij dhe Nerxhivane Daka per kryerje te vepres penale te "keqperdorimit te detyres zyrtare apo pozites"ne kundershim me nenin 339 te KPPK-se dhe "marrja e rryshfetit" ne kundershim me nenin 343 te lidhur me nenin 20 dhe 23 te KPPK-se, ai ka shkuar ne shkrimore te gjykates dhe kishite kontrolluar dosjen e rasis, dhe mbas ketij kontrolli te pa autorizuar, nepërmjet bisedes telefonike ku ai e kishite me te pandehurin Gani Rukiqi me 14 Gusht 2007 ne prezenc te Rexhep Ibishit, ku kane komunikuar dhe ia mundesoi atij informata lidhur me iniciimin e procedures hetimore. Keto informata perbenin nje sekret zyrtar, zbulimi i te cilit ka shaktuar apo mund te kishite shaktuar pasojat te demshme. Prandaj me kete veprim ai kishite penguar zhvillimin normal te procedures penale.

I pandehuri i dyte, Gani GRAJQEVCI

Me 13 dhe 17 Gusht 2007, ne cilesin e nenpunesit te zyles se regjistrimit te Gjykates se Qarkut te Prishtines, si vazhdim i shenimeve te lartcekura reth procedures hetimore ai, si person pergjegjjes ne prezenc te kolegeve te tij, te pandehurit te pare Enver Zhittas pa autorizim ka komunikuar dhe ia mundesoi informata nje personi te pa autorizuar, Rexhep Ibishit, lidhur me shenimet e procedures hetimore te lartcekura, informatat te cilat perbenin nje sekret zyrtar, zbulimi i te cilit ka shaktuar apo mund te shaktonte pasoja te demshme. Me vone me 20 Gusht 2007 ai ka komunikuar informta te njejta personit te quajtur Flamur Bogaj, ku ai kishite penguar zhvillimin normal te procedures penale.

I pandehuri i trete, Selman BOGIQI

Ne cilesin e personit zyrtar, duke vepruar si gjyqtar i procedures paraprake te Gjykates se Qarkut te Prishtines ne procedure penale te lartcekur te inicuar kunder te pandehurve Gani Rukiqi, Drita Rukiqi dhe Nerxhivane Daka si inspektor te ndertimtarise ne komunën e Prishtines, per vepren penale te lartcekur ne baze te aktvendimit 58/07 te dates 26 Korrik 2007, me qellim dhe pa autorizim, nepermjet bisedave telefonike me te pandehurin Gani Rukiqin kane komunikuar dhe ia mundesun atij



informata detaljike lidhur me procedurat hetimore te lartcekuarata te inicuarra kunder tji, informata te cilat perbenin sekret zyrtar, zbulimi i te cilit ka shkaktuar apo mund te shkaktonte pasoja te demshme.


Si rriedhoj, i pandehuri Selman Bogiqi ka demtuar proceduren penale kunder te pandehurin Gani Rukiqi, Drita Rukiqi dhe Nerxhivane Daka, te cilat ishin te dyshuar per marjen e ryshtetit nga pala e demtuar, domethen inicues te kallximit penal, Agim Kryeziu, qytetar i Prishtines.

A. Ligji i Aplikueshem

i. Neni 347 te Kodit te Perkohshem Penal te Kosoves

Neni 347 parashen

- (1) Personi zyrtar i cili pa autorizim kumton, dergon ose ne ndonje menyre tjetër i ve ne dispozicion personit tjetër informacionin i cili përbën një fshehtësi zyrtare ose siguron informacionin e tillë me qëllim të përcjelljes te një perosn i pautorizuar dënohet me burgim deri në tri vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer për përfitim personal ose me qëllim të publikimit a shfrytëzimit të informacionit jashtë Kosovës, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- (4) Dispozitat nga paragrafet 1 deri te paragrafi 3 i këtij neni zbatohen ndaj personit i cili e ka zbuluar sekretin zyrtar edhe pasi që statusi i tij zyrtar ka pushuar.
- (5) Sipas këtij neni shprehja "fshehtësi zyrtare" do të thotë informata ose dokumente të shpallura me ligj, dispozita të tjera ose me vendim të organit kompetent të nxjerra në bazë të ligjit e që konsiderohen fshehtësi zyrtare, zbulimi i të cilave ka shkaktuar ose mund të shkaktojë pasoja të dëmshme.



B. Histori procedurale

Me 26 Korrik 2007 SPRK-ja ka leshuar aktvendimin ne iniciimin e hetimit¹ kunder Gani Rukiqit, Drita Rukiqi dhe Nerxhivane Daka, per vepren penale te "keqperdorimit te detyres zyrtare apo pozites"ne kundershtrim me nenin 339 te KPPK-se dhe "marria e ryshtetit" ne kundershtrim me nenin 343 te lidhur me nenin 20 dhe 23 te KPPK-se.

Me 26 Korrik 2007 Gjyakata ka leshuar urdherin per pergjimet telefonike te numrit te telefonit 044-173-255 i poseduar dhe i perdorur nga Gani Rukiqi; numer tjeter telefoni 044-200-158 i poseduar dhe i perdorur nga Drita Rukiqi dhe numri i telefonit 044-141-794 i poseduar dhe i perdorur nga Agim Kryeziu. Keto urdhera do te jene ne fuqi ne periudhe kohor nga 27 Korriku deri ne 23 Shtator 2007.

Me 24 Janar 2008 SPRK-ja ka parashtruar vendimin per zgjatjen e hetimeve kunder te pandehurit te trete per vepren penale te ndihme dhe mbeshtetje te kryesit nen nenin 305 te KPK-se, shkelje te sekretve procedurale te percaktuara ne nenin 311 te KPK-se, ryshteti i percaktuar ne nenin 343 te KPK-se dhe ushtrimi i ndikimit te percaktuar ne nenin 345 te KPK-se.


Me 27 Shkurt 2008 gjykat ka leshuar urdherin vijues per pergjimin e bisedave telefonike per numrin telefonik 044-173-255 i poseduar dhe i perdorur nga Gani Rukiqi; numer tjeter te telefonit 044-200-158 i poseduar dhe i perdorur nga Drita Rukiqi dhe numri i telefonit 044-124-172 i poseduar dhe i perdorur nga i pandehuri i trete Selman Bogiqi. Ai urdher do te mbetet ne fuqi ne periudhe kohor nga 27 Shkurt deri ne 26 Prill 2008.

Hetimet kunder Gani Rukiqit jane nderprer konform vendimit te nderprerjes se hetimeve te dates 12 Maj 2009.

Me 8 Shtator 2008 Prokurori Special ka leshuar aktvendimin nen numrin PP 778-7/08 per nderprerjen e hetimeve kunder Drita Rukiqit, Nerxhivane Daka dhe Selman Bogiqit.

Me 6 Nentor 2008 prokurori nderkombtar i prokurorise se qarkut ka leshuar aktvendimin CIR nr 2007/644/PRS/NM ne rastin me numer PP 778-7/08 per terhiqjen e aktvendimit per nderprerjen te hetimeve kunder Selman Bogiqit.

¹ Te parashtruar me 03.08.2007 me SEC nr 58/07



Me 12 Maj 2009 I pandehuri Selman Bogiqi ka parshtruar kerkesen per mbrojtjen e ligjeshmerise ne Gjykaten Supreme te Kosoves. Gjere ne fillimin e ketyre procedurave kerkesa nuk eshte percaktuar nga Gjykata Supreme.

Mbrojtja per Selman Bogiqin theksoi se gjykata nuk duhet te degjoje deshmite deri sa te vendoset reth kerkeses.

Neni 224 i KPPK-se parashihet se prokuroria duhet

... duhet te nderpres hetimin nese ne qfardo kohe eshte evidentuar nga deshmit e grumbulluara se:

- 1) Egziston dyshimi i arsyeshem se personi i vegante ka kryer veprën penale te treguar.
- 2) Akti i raportuar nuk eshte veper penale qe eshte ndjekur ex-officio
- 3) Periudha kohore e limituar e parashikuar me statut per ndjekje penale nuk ka eskaduar
- 4) Vepra penale eshte mbuluar nga amnestia apo falja; apo
- 5) Egzistojne rethana te tjera qe e parandalon ndjekjen.

Nderpererja e hetimeve te dates 8 Shtator 2008 eshte bazuar ne nenin 224 (1) nen paragrafi (1).

Konform neni 6 (3), 46 (1) dhe 220 (1) dhe (3) te KPPK-se prokurori mund te hetoj veprat e supozuara dhe ti gjykoj ato kunder atyre qe egziston dyshim i bazuar.

Prokuroria theksoi klasifikimin ilgjor te vepres, pjesa e propozimit te aktakuzes se tanishme eshte ndryshe nga veprat e vendimit per zgjerimin e hetimeve te dates 24 Janar 2008. Ne fakt vendimi per te zgjeruar hetimet referohet veprave te mundshme nen nenin 311 te KPPK-se. Ne qfardo ngjarje, bazat faktike pjese e vendimit per zgjerimin e hetimeve jane te rendesishme sikurse edhe supozimet faktike te pjeses se propozimit te aktakuzes.



Vendimi prokurorit special te leshuar me 6 Nentor 2008 per terheqjen e aktvendimit te tij te me hershem per nderperrijen e hetimeve ishte disi befasesues. Eште vendim i i cili ri shfaq se hetimet nuk duket te jenë te bazuara ne baze te shfaqjes se fakteve te reja apo deshmive. Ne te vertet aktvendimi thjeshte deklaronte;

“ Mbas shqyrtimit te me tejme te rasit, zyra jone beson se aktvendimi duhet te terhiqet”.

Neni 438 i KPPK-se parashen


Procedura penale e përfunduar me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet me kërkesën e personave të autorizuar vetëm në rastet dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod.

Lidhur me nenin 438 per “procedurat penale’ dhe nderperrijes se tyre nga ‘aktvendimi i formes se prerë’ eshte qarte referenca per aktvendimin e formes se prerë te gjykates.

Neni 4 i KPPK-se parashen

- (1) Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penalekundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.
- (2) Vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike vetëm në favor të personit të dënuar...

Akuzat pjese e propozimit te aktakuzes nuk jane percaktuar me heret me vendim te formes se prerë nga Gjykata. Ne rrethana te ketilla kjo qeshija nuk eshte Res Judicata.



Ne vazhdim, aktvendimi per nderperjen e hetimeve dhe aktvendimi pasues mbi terheqjen e aktvendimit per nderperjen e hetimeve nuk e paragjykon te pandehurin ne keto procedura.

C. Deshmi

Nuk ka dyshim ndermjet paleve se me 3 Gusht 2007 Gjyakta e Qarkut ne Prishtina ka pranuar nga SPRK-ja aktvendimn per iniciimin e hetimeve ne rastin me numer SEC 58/07. Po ashtu nuk eshte diskutabile se ne te njejten dite puntori i gjyakes, Autfete Krasniqi, e ka regjistruar rastin ne regjister te PPH me numer PPH 223/07.

Prokuroria e ka ftuar Rexhep Ibishin². Ai eshte nipi i te pandehurit te pare, Enver Zhita. Z. Ibishi eshte marrur ne pyetje nga prokurori special me 23 Maj 2008³.

Z. Ibishi ka deshmuar se ai e njihje Gani Rukiqin qe nga shkolla e mesme.

Z. Ibishi deshmoi se ai here pas here e vizitonte dajen e tij ne Gjykatën e Qarkut te Prishtines. Atij i kujtohet vizita e tille ne vitin 2007. Ai deshmoi se kishte shkuar ne gjykatën e qarkut per te pyetur rreth rastit ne te cilen ai ishte i perfeshire. Ishte e dukshme nga transkriptimet egzistuese te pergjimeve telefonike qe ai takim ka ndodhur me 13 Gusht 2007.

Z. Ibishi ka deshmuar se gjate vizites se tij ne gjykatën e qarkut i pandehuri i pare e ka njoftuar qe e kishte pare emrin e Gani Rukiqit ne dokumentin e Gjykes. Ne te vertet ai eshte referuar regjistrin te PPH-se.

Z. Ibishi nuk mund te kujtonte qe i pandehuri i par eshte referuar dikujt me emer. Sidoqoft, me 13 Gusht 2007 ne ora 10:48:02 Rexhep Ibishi kishte biseduar me Gani Rukiqin. Gjate asaj bisede telefonike Z. Ibishi e ka njoftuar Z. Rukiqin se Drita Rukiqi dhe Nerxhivane Daka po ashtu ishin te perfeshira.

Z. Ibishi deshmoi se i pandehuri i pare e ka ditur qe ai dhe Gani Rukiqi ishin shoke. Eshte supozuar se per keto arsye i pandehuri i pare i ka dhene kete informate nipit te tij. Ai deshmoi se ne ate faze nuk ishte ne dijeni rreth detajeve specifike te akuzave.

² Hetimet kunder Z. Ibishit eshte nderprer conform vendimit per nderperje te hetimeve te dates 12 Maj

2009

³ Prova P5



Z. Ibishi deshmoi se mbas shkuarjes se tije nga Gjykata e qarkut ai e mori ne telefon Gani Rukiqin me qellim te informimit per rastin kunder tij. Z. Ibishi rrijedhimisht e takoi Gani Rukqin ne ndertesen e komunes ku Gani Rukiqi punonte.

Z. Ibishi deshmoi qe ai e njihje Drita Rukiqin qe nag shkolla e mesme. Ai po ashtu e njihje Nerxhivane Daken. Ai deshmoi se nuk e njihje te pandehurin e trete.

Z. Ibishi deshmoi se, ne kohen fillestare te bisedes me Gani Rukiqin , ai nuk ishte ne dijeni se rasti ne fjale ishte caktuar tek i pandehuri i trete.

Sidoqoft, eshte qarte nga transkriptimet te pergjimit te bisedes telefonike qe me 13 Gusht 2007 rreth ores 10:48 Z. Ibishi kishte njohuri per rastin qe eshte caktuar tek i pandehuri i trete.

Prokuroria e ftoi **Gani Rukiqin**. Ai punonte per komunen e Prishtines gjate viteve 1999-2008. Nga Korriku i vitit 1999 deri ne vitin 2003 ai punoi si nenpunes i ndermtarise. Nga viti 2003 deri ne vitin 2008 ai ishte ushtruesi i detyres se ekipit te inspektimit per ndermtitari.

Z. Rukiqi eshte intervistuar si deshmitar nga ana policore me 5 Maj 2008⁴.

Z. Rukiqi deshmoi rreth takimit qe ai e kishte me Rexhep Ibishin, mbas takimit te Z. Ibishit me te pandehurin e pare. Ai deshmoi se Z. Ibishi e informoi ate se rasti kishte filluar ne Gjykaten e Qarkut kunder tij, Drita Rukiqi dhe Nerxhivane Daka. Drita Rukiqi dhe Nerxhivane Daka ishin koleget e tij ne ekipin e inspektimit.

Z. Ibishi me heret kishte deshmuar prane kesaj Gjykate se i pandehuri i pare ka cekur vetem qe ka pare emrin e Gani Rukiqit. Ajo nuk ishte e sakte.

Z. Rukiqi dehmoi se ai e ka pyetur Z Ibishin qe ta kontaktoj te pandehurin e pare dhe te hulumtoj rreth rastit. Qarte ai donte te dinte me shume rreth akuzave. Ne ditën e njejte ai e zbuloi se rasti eshte caktuar te i pandehuri i trete.

Z. Rukiqi eshte intervistuar nga policia me 5 Maj 2008. Gjate asaj interviste ai eshte pyetur

⁴ Prova P4



“ ju lutem na jepni emrat e njerzeve te cilat ju siguruan juve informatat lidhur me hetimet penale kunder juve.”

Ne pergjigje Z. Rukiqi deshmoi

“Rexhep Ibishi, neprmejt (te pandehurit te pare) “

Z. Rukiqi deshmoi se ai ka folur vetem njeher me te pandehurin e pare.
Z. Rukiqi e pershkroi biseden telefonike me Z. Ibishin. Gjate asaj bisede Z. Ibishi ia dha telefonin e tij te pandehurit te pare i cili me pas kishte biseduar me Z. Rukiqi. Eshte qarte nga pergjimet te bisedes telefonike⁵ qe ajo bisede ka marre pjese me 14 Gusht 2007.

Z. Rukiqi deshmoi qe ai kurre nuk e ka vizituar te pandehurin e pare ne zyren e tij ne Gjykatën e Qarkut. Ai ne vazhdim deshmoi qe i pandehuri i pare nuk e kishte informuar reth permbytjes se akuzes.

Z. Rukiqi deshmoi se ai dh ei pandehuri i trete ishin nga i njejti fshate. Ata e njlnin njeri tjetrin per 35-40 vite.

Z. Rukiqi deshmoi reth takimit me te pandehurin e trete dikur me vone ne shtepi. Eshte e qarte nga transkriptimet te pergjimit te bisedes telefonike qe kjo ka ndodhur me 16 Gusht 2007⁶. Po ashtu te pranishem ne takim ishin Drita Rukiqi dhe Nerxhivane Daka.

Ne deshmin e tij, Z. Rukiqi e pershkroi pranin e Drita Rukiqit dhe Nerxhivane Daka si nje raste te qarte. Ai theksoi se ishin ne fushë se bashku. Ne pergjimin e bisedes telefonikendermjet Gani Rukiqit dhe te pandehurit te trete menjher para atij takimi⁷, Gani Rukiqi deklaroi

“une desha te vij dhe t’ju shohë se bashku me Nexhen dhe Driten”

Z. Rukiqi pershkroi takimin tek shtepia e te pandehurit te trete e cila ka zgjatur diku 30-40 minuta. Ai deshmoi se ata kishin diskutuar reth rastit ne fjale gjate atij takimi.

⁵ Prova P1

⁶ Prova P1

⁷ Prova P1



Kur Z. Rukiqi eshte intervistuar nga Policia ne Maj 2008⁸ ai eshte pyetur reth takimit. Ai deshmoi;

“... ne kemi biseduar reth rasti tim dhe i kame thene se Rexhepi me ka treguar reth rasti dhe se rasti eshte i caktuar me Selmanin”

Z. Rukiqi deshmoi prane kesaj gjykate reth takimit tjetër me te pandehurin e trete me Gjykatën e Qarkut ne Prishtine. Takimi ka ndodhur ne zyren e te pandehurit te trete.

I pandehuri i trete po ashtu deshmoi prane kesaj gjykate reth atij takimi. Ai takim ka ndodhur me 3 Shtator 2007.

Z. Rukiqi deshmoi se gjate atij takimi i pandehuri i trete e konfirmoi se rasti eshte parashtuar kunder tij nga Agim Kryeziu. Ai ne vazhdim deshmoi se i pandehuri i trete i paska dhene “ padin “ te parashtuar nga Agim Kryeziu per te lexuar.

Gjate marrtese ne pyetje nga mbrojta e te pandehurit te trete Z. Rukiqi si rjedhoje e mohoi qe i pandehuri i trete i paska dhen ndonje dokument per te lexuar.

Mbrojtja per te pandehurin e trete e vendosi ne evidence dosjen originale te gjykates me numer PPH 223/2007⁹. Ne baze te referimit te dates ne vule ne dokumentet e ndryshme qe permbajne aty, ne kohen e ketij takimi, dosja e gjykates permbante vetem aktvendimin reth inicimit te hetimeve te dates 26 Korrik 2007.

Kur Z. Rukiqi eshte intervistuar nga Policia ne Maj 2008¹⁰ ai eshte pyetur nag Policia:

“ a ju ka garantuar ndonjeher ne ndonje menyre, qe ai do te siguronte (i pandehuri i trete) qe ju nuk do te jeni te demtuar nga ky rasti?”


Ne pergjigje ai deshmoi

“jo, ai tha qe do te me ndihmonte mirpo nuk me ka siguruar qe ai do te bente qdo gje”

⁸ Prova P4

⁹ Prova D3,4

¹⁰ Prova P4



Z. Rukiqi dëshmoi qe rjedhimisht ai ishte i kontaktuar neprimjet telefonit nga i pandehuri i trete i cili ka kerkuar qe te ndermarr disa pune duke e perfeshir vlersimin e nderimit per villaun e te pandhurit te trete. Ne ate kohe Z. Rukiqi ende ishte duke punuar per kuvendin komunal. Ai theksoi qe e paska caktuar rastin te njeri prej nempunsve te tij. Z. Rukiqi deklaroi se ai kurre nuk ka kerkuar ng ai pandehuri i trete ndonje sherbim dhe se i pandehuri i trete asnjeher nuk ka kerkuar nga ai ndonje sherbim.

Prokuroria e ftoi **Drita Rukiqin**. Ne vitin 2007 ajo ishte e punesuar si Inspektor i nderimit nag Drejtorati per Inspektim te nderitimeve.Koleget e saj ishin Gani Rukiqi dhe Nerxhivane Daka.

Zonja Rukiqi eshte intervistuar si deshmitar nga policia me 5 Maj 2008. Ajo dëshmoi se nuk e dinte naturen e akuzimeve.


Zonja Rukiqi dëshmoi se heren e pare qe ajo ishte ne dijeni qe ishte si e dyshuar per hetimet penale ishte kurë ajo vijoi proceduren ne Gjyakte ne Korrik te vitit 2009. Ne fakt, ajo nuk ka pranuar kopjen e vendimit per nderprejje te hetimeve te dates 8 Shtator 2009. Kopja e atij vendimi eshte derguar para se ajo te jep dëshmi prane kesaj Gjykate.

Ne pergjigje te pyetjes te bere nga mbrojtesi i te pandehurit te trete, Zonja Rukiqi dëshmoi se Gani Rukiqi kure nuk e ka informuar ate qe ajo ishte pjese e hetimeve penale. Kjo ishte në kundërshtim me dëshminë e Nerxhivana Dakas për të cilën do të referohem më poshtë.

Me të vërtetë, Gani Rukiqi dëshmoi se Rexhep Ibishi e kishte njoftuar për hetimet kundër tij, Drita Rukiqit dhe Nerxhivana Dakas. Është e pakuptueshme që ai nuk do ta njoftonte Drita Rukiqin për atë hetim.

Znj. Rukiqi dëshmoi se ajo nuk e dinte se i Pandehuri i Tretë ishte gjyqtar. Kjo do të ishte befasuese duke marr parasysh se ata më herët kanë punuar bashkë.

Duke i referuar takimit me të Pandehurin e Tretë në shtëpinë e tij, Znj. Rukiqi dëshmoi se Gani Rukiqi dhe Nerxhivane Daka kanë qenë të pranishëm. Ishte nga kujtesa e saj se takimi ka zgjatur për afërsisht 10 minuta. Ajo dëshmoi se takimi ishte ujditur nga Gani Rukiqi dhe se biseda ishte e kufizuar brenda diskutimit rreth lëndimeve të marrë të Pandehurit të Tretë dhe bashkëshortes së tij në aksidentin e trafikut në Mal të Zi.



Znj. Rukiqi dëshmoi se ajo kurrë nuk e ka takuar e as që ka pasur komunikim me të Pandehurin e Parë.

Prokuroria e ftoi **Flamur Bogajin**, djalin e të Pandehurit të Tretë Selman Bogiqi. Zt. Bogaj e ushtroi të drejtën e tij që të mos dëshmon sipas nenit 160 (2) të KPPK-s.

Sipas nenit 160 (5) Gjykata e liroj Zt. Bogaj nga çdo obligim i dëshimit kundër të Pandehurit të Parë dhe të Dytë sepse lidhaji ndermjet te pandehurve ishte e tillë sa qe do të ishte e pamundshme të kufizohet dëshmia e tij vetëm te ata të Pandehur.

Prokuroria e ftoi **Nerxhivane Daka-n**. Ajo e përshkroi punën e saj në vitin 2007 si Operatore në terren në ndërtim. Ajo ishte e punësuar në Komunë. Në mesin e kolegëve të saj ishin Gani Rukiqi dhe Drita Rukiqi.


Znj. Daka ishte e intervistuar si dëshmitare nga policia më 5.05.2008¹¹. Asaj i ishte dorëzuar kopja e Vendimit mbi Ndërprerjen e Hetimeve të datës 8.09.2008 para se të dëshmon në këto procedura.

Znj. Daka dëshmoi se ajo ishte e njoftuar nga Gani Rukiqi në muajin Gush/ Shtatorit 2007 se ajo, Gani Rukiqi dhe Drita Rukiqi janë temë e hetimeve penale. Ajo dëshmoi se Gani Rukiqi nuk e njoftoj atë mbi substancën e supozimeve ose, prej kujt ai ka kuptuar këtë informatë. Ajo nuk mund të rikujtonte nëse dikush tjetër ishte i pranishëm në atë takim.

Znj. Daka dëshmoi se ajo diskutoi rreth hetimeve penale me Drita Rukiqin në të njëjtën ditë kur u njoftua për hetimet nga Gani Rukiqi. Kjo ishte në kundërshtim me dëshminë e Drita Rukiqit e cila kishte dëshmuar prane kësaj Gjykate se hera e parë kur ajo u bë e vetëdijshme se ajo ishte e dyshuar në hetimet penale, ishte në muajin korrik 2009.

Edhe ajo dëshmoi rreth takimit në shtëpinë e të Pandehurit të Tretë. Znj. Daka dëshmoi se ajo ishte në terren kur Gani Rukiqi sugjeroi të takojnë të Pandehurin e Tretë të pyesin rreth shëndetit të tij pas aksidentit të trafikut në Mal të Zi. Ajo dëshmoi se ajo, Gani Rukiqi, Drita Rukiqi, i Pandehuri i Tretë dhe e shoqja e të Pandehurit të Tretë ishin të pranishëm në dhomën e njëjtë gjatë gjithë takimit. Ajo mendoj se takimi

¹¹ Prova P3



zgjati jo më shumë se 30 minuta. Znj. Rukiqi dëshmoi se ajo e kaloi të shumtën e kohës duke folur me bashkëshorten e të Pandehurit të Tretë. Ajo nuk dëgjoji se çfarë diskutime patë lidhur me të Pandehurin e Tretë.

Znj. Daka dëshmoi se ajo e dinte se i Pandehuri i Tretë ishte gjyqtar. Ajo dëshmoi se ajo nuk ishte e njoftuar nga Gani Rukiqi se i Pandehuri i Tretë ishte gjyqtari ndaj të cilit i ishin caktuar heqimet penale. Ajo kurrë nuk e ka takuar e as nuk ka komunikuar me të Pandehurin e Parë.

Është e pakuptueshme që Znj. Daka, e dyshuara në heqimet penale, do të vijonte takimin në shtëpinë e gjyqtarit të cilit i është caktuar rasti e të mos jetë e vetëdijshme për këtë fakt.


Vërtet, transkriptimet e përgjimeve të ndryshme telefonike e mbështesin pohimet e Prokurorisë se të tri të dyshuarit ishin të vetëdijshëm që në fazën e hershme të hetimeve se ata ishin temë e hetimeve dhe se para takimit me të Pandehurin e Tretë, ata e dinin se ai rast i ishte caktuar atij.

I Pandehuri i Tretë e ftoi Artifete Krasniqin.

Znj. Krasniqi kishte punuar në Regjistrin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë prej viti 2001. Ajo e ndante zyrën me të Pandehurin e Dytë. Ajo ishte përgjegjëse për regjistrimin e rasteve penale derisa i Pandehuri i Dytë ishte përgjegjës për regjistrimin e rasteve civile. Si duket ndërmjet veti ata kishin një marrëveshje joformale se, në rast mungese, secili do ta bënte punën e tjetrit.

Znj. Krasniqi dëshmoi se ajo ishte në pushim prej 6 gushtit deri në fund të muajit gusht 2007. Ajo nuk mund të mbante ndërmend datën e saktë kur ajo u kthye në Gjykatë. Gjykata regjistron se Znj. Krasniqi ishte në pushim prej 6 - 29.08.2007. Nuk ka mosmarrëveshje se më 3.08.2007 Gjykata e Qarkut në Prishtinë pranoi nga PSRK Aktvendimin mbi Nismën e Hetimeve me numër të rasisit SEC 58/07.

Gjithashtu nuk ka mosmarrëveshje se në të njëjtën ditë Znj. Krasniqi e regjistroi atë rast në regjistrin PPH me numër të rasisit PPH 223/07. Kjo, dukej, se nuk ishte në kundërshtim me praktikën e saj të rëndom gjatë regjistrimit të rasteve SEC.



Znj. Krasniqi dëshmoi se ajo zakonishte do te pranonte rastet SEC në pliko të mbyllura. Ajo nuk i hapte plikot. Dëftesa e plikos futej në një regjistër tjetër të ndarë. Ajo dëshmoi se ajo nënshkruante plikon e mbyllur me numër të dosjes dhe e fuste në regjistrin e duhur emrin e gjyqtarit të cilit i ishte caktuar rasti.

Duke i referuar rastit me numër PPH 223/07, Znj. Krasniqi dëshmoi se Aktvendimi mbi Nismën e Hetimeve nuk ishte në plikon e mbyllur kur ajo e pranoi atë.

Regjistri i Marrjeve të Gjykatës¹² përmban një hyrie për 3.08.2007 me numër 970 me referim “Sec-mo 58/07” që regjistron pranimin e “Aktvendimit”¹³.

Referimi “Aktvendimit” në Regjistrin e Marrjeve do të sugjeronte se Aktvendimi mbi Nismën e Hetimeve nuk ka ardhur në Gjykatë e mbyllur në pliko ose, nëse ka ardhur, ishte hapur nga nëpunësi i Gjykatës para se të regjistrohej në Regjistrin e Marrjeve. Regjistri përmban hyrie të tjera që referojnë pranimit të “plikove”¹⁴.

Në krye, në këndin e djathtë të Aktvendimit mbi Nismën e Hetimeve të datës 26.07.2007 është vula me ditë e Gjykatës e nënshkruar me datën dhe kohën e pranimit. Aty gjithashtu është edhe numër referimi “970” që përputhet me numrin në kolonën e “datës së dërgimit”¹⁵ në Regjistër. Në krye këndin e majtë të Aktvendimit është numri i rastit “Sec.nr. 58/07”.

Ndonëse ky ishte një SEC rast – dhe Znj. Krasniqi e fyi atë si të tillë në Regjistrin PPH¹⁶ - ajo dëshmoi se asaj nuk iu duk e çuditshme që Aktvendimi nuk ishte në plikon e mbyllur kur ajo e pranoi atë.

Znj. Krasniqi dëshmoi se ajo e regjistroj emrat e të Dyshtuarve në Regjistrin PPH. Duke marrë parasysh se ky ishte një rast SEC dhe duke

¹² Prova D3.2

¹³ Aktvendim

¹⁴ Pliko

¹⁵ Data e dërgimit

¹⁶ Prova D3.1



marrë parasysh se, në vet dëshminë e saj, rastet e tilla regjistronen në mënyrë tjetër nga rastet PPH, është befasuese se ajo e regjistroi këtë rast në këtë mënyrë.

Znj. Krasniqi dëshmoi se, pasi e regjistronte rastin, ajo zakonisht e jepte dosjen gjyqtarit të cilit i ishte caktuar rasti. Ajo nuk mund të kujtonte se kur e bëri ajo këtë në këtë rast.

Znj. Krasniqi dëshmoi se gjatë orarit të punës regjistrat e ndryshëm qëndronin mbi tavolinën e saj në zyrën e saj. Pas orarit të punës regjistrat futeshin brenda nëpër sirtarë të mbyllur.

Znj. Krasniqi dëshmoi se ajo kurrë nuk diskutoi rastin SEC në çështje me ndonjë nga të Pandehurit.

Prokuroria e la në dëshmi **transkriptimet e përgjimeve të bisedave telefonike** të marra sipas urdhrave të Gjykatës më 26.07.2007 dhe 27.02.2008. Do ti referohem këtyre kur të konsideroj dëshminë lidhur me secilin nga të Pandehurit.

Versioni shqip i transkriptimeve të atyre përgjimeve telefonike janë pajtuar nga të Pandehurit.


Këtu i referohemi atyre pjesëve nga transkriptimet në fjalë.

I Pandehuri i Parë, **Enver Zhita** dëshmoi në mbrojtjen e vet. Ai është marr në pyetje si i Dyshuar më 23.05.2008¹⁷.

I Pandehuri i Parë dëshmoi rreth takimit me nipin e tij Rexhep Ibishin në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Ndonëse ai nuk mund të kujtonte datën, ishte e qartë se ai i referohej takimit më 13.08.2007 rreth të cilit Rexhep Ibishi tashmë dëshmoi.

I Pandehuri i Parë dëshmoi se Zt. Ibishi e pyeste për një rast në të cilin ai ishte i përfshirë që procedohej para Gjykatës së Qarkut. I Pandehuri i Parë shkoi në Regjistrin e Gjykatës të pyes për numrin e atij rasti. Derisa kontrollonte Regjistrin PPH për referim atij rasti që i interesonte Zt. Ibishit, I Pandehuri i Parë e pa se rasti ishte i regjistruar kundër Gani Rukqit. Ky ishte shenim i regjistrit rreth asaj qka zonja Krasniqi ka dëshmuar.

¹⁷ Prova P7



I Pandehuri i Parë dëshmoi se ai ishte shok me Zt. Rukiqin që 30 vite.
I Pandehuri i Parë dëshmoi se ai e kishte njoftuar Rexhep Ibishin rreth rastit kundër Gani Rukiqit. Ai nuk mund të kujtonte nëse personat e tjerë përmendeshin në Regjistrë.

Ndonëse I Pandehuri i Parë me sinqeritet e pranoi se kishte dhënë Zt. Ibishit informatën nga Regjistri PPH, çështje tjera shqetësuese dalin, inter alia, përmbajtja dhe

burimi i informatës së zbuluar dhe në çfarë mase, nëse po, kjo përfshinte të Pandehurin e Tretë.

Prokuroria e la në dëshmi transkriptimin e bisedës telefonike më 13.08.2007 në ora 10:40:36 midis Gani Rukiqit dhe Rexhep Ibishit.

Gani: Rexh

Rexhep: Jam duke e shikuar, të lajmëroj më vonë


Gani: çka thotë Enveri

Rexhep: Mirë, të lajmëroj menjëherë, jam me të

Gani: duket e pakuptimtë

Duke marrë parasysh kontekstin ku është përdorur, Gjykata gjen se referimi "Enverit" është referimi të Pandehurit të Parë.

Në kohën e asaj bisede telefonike Zt. Ibishi dukej se nuk ishte dinte për pohimet e pavërtetuara thelbësore të Enverit dhe heqja e Enverit nga lista e referencave kundër Gani Rukiqit.



I Pandehuri i Parë dëshmoi se ai të ditë kur zbuloi ekzistimin e rasit kundër Gani Rukiqit, ai foli me Gani Rukiqin në telefon.

Prokuroria e la në dëshmi transkriptimin e bisedës telefonike më 13.08.2007 në ora 10:48:02 midis Rexhep Ibishit dhe Gani Rukiqit:

Rexhep Ibishi: Shkova atje, e kishin dorëzuar, rasti ka arritur te Selmani, por ai është në pushim. Nga ato çka kuptova nga axha Enveri, nuk përmend shumë, më thirrën për një kafe të pimë ti paguaj të bëjnë diçka.

Gani Rukiqi: Kush ishte?

Rexhep Ibishi: Nuk patë emër; emri është me Selmanin, lshiti ti, Drita dhe Nerxhivane, kush është Nebahate?


Gani Rukiqi: Nerxhivan Daka, a ishte Nerxhivan Daka. A e pa ti kopjen?

Rexhep Ibishi: Jo kopjen por librin ku është regjistruar, thotë Gani Rukiqi, Drita Rukiqi dhe Nerxhivane Daka kanë kërkuar rryshfet për dike, e kanë ftuar në kafe të flasin me të, të marrin rryshfet, asnjë shumë hollash e asgjë tjetër nuk është caktuar.

I Pandehuri i Parë dëshmoi se informata e vetme që i dha Rexhep Ibishit ishte e përfshirë në Regjistrin PPH¹⁸. Ai mohoi dijeninë reth përmbajtjes së pohimeve të pavërtetuara.

Mirëpo, gjatë atyre bisedave telefonike është referuar pohimeve thelbësore të pavërtetuara. Ndonëse Regjistri i referon Neneve të Kodit Penal që janë të mëdha e hetimeve, nuk përmban hollësitë e pohimeve thelbësore të pavërtetuara. Në ballinë të transkriptimit duket se i Pandehuri i Parë ka pasur qasje të informatat tjera shpeshë reth pohimeve thelbësore të pavërtetuara. Mirëpo, asnjë referim i mëtejshëm lidhur me to është bërë gjatë bisedës telefonike. Komentet e bëra nga Zt. Ibishi

¹⁸ Prova D 3.1



gjatë asaj bisede telefonike, duken te jene te bazura më shumë mbi supozime se dijeni aktuale të pohimeve thelbësore të pavërtetuara.

Prokuroria e la në dëshmi transkriptimin e bisedës telefonike më 13.08.2007 në ora 11:00:02 midis Gani Rukiqit dhe Rexhep Ibishit:

Gani: Ose ti më prit ose unë të pres. A u takove me Enverin ose me kë tjetër?

Rexhep: Po, me Enverin dhe Ganin.

Gani: Kush është Ganiu?

Rexhep: Ganiu është ai që pranon rastet

Gani: A nuk munde të shohësh më shumë hollësi?

Rexhep: Jo, sepse ishte dërguar Selmanit.

Duke marrë parasysh kontekstin ku është përdorur, Gjykata gjen se referimi "Ganiu" është referimi të Pandehurit të Dytë.


Gjatë asaj bisede Rexhep Ibishi e njoftoi Gani Rukiqin se ai ishte me të Pandehurin e Parë dhe të Dytë. Ai deklaroi se nuk ka informata më tej sa i përket hetimeve.

Prokuroria e la në dëshmi transkriptimin e bisedës telefonike më 14.08.2007 në ora 7:57:13 midis Gani Rukiqit dhe Rexhep Ibishit:

Rexhep: ...ai më tha se do të më thirr por unë do të shkoj pa më thirr ai.

Gani: Po, shko pa të thirrur ai në rast se harron a po i vjen turp të thotë. I thuaj axha Enver të lutem bëjë këtë punë për mua, dhe ky është sekret i madh midis neve dhe më thirr menjëherë.

Rexhep: Mirë, mos u brengos, nuk duhet të brengosesh mos e bëjë këtë punë të madhe. Nuk ka asgjë aty.



Gani: E di se nuk ka asgjë, por dua të di nga kush duhet të kem kujdes. Ky është një shqetësim i madh por është një lloj i mësimit. Do të mbes borxh tërë jetën. Tung.

Zt. Ibishi më pas u takua me të Pandehurin e Parë.

Prokuroria e la në dëshmi transkriptimin e bisedës telefonike më 14.08.2007 në ora 09:04:11 midis Gani Rukiqit dhe Rexhep Ibishit:

Gani: Tung: Çka ka të re

Rexhep: Jam te axha Enver, përveç shënimeve që i morëm dje nuk mund të bëjmë asgjë tjetër derisa Selmani nuk kthehet, mund të flasësh me axhën Enver nëse do.

...

Gani: ...Pra nuk mund të bën asgjë he,

Zhitta: Jo, nuk mund të bëjë asgjë derisa ata të mos kthehen nga pushimi.

Gani: Pra është e sigurt se rasti është me Selmanin a po jo?

Zhitta: Po, po është.

Gani: Mirë, faleminderit.

Zhitta: Hajt, mos u brengos.

Gani: Tung.

Gjatë asaj bisede telefonike i Pandehuri i Parë konfirmoj se rasti i është caktuar të Pandehurit të Tretë.

Prokuroria e la në dëshmi transkriptimin e bisedës telefonike më 14.08.2007 në ora 10:06:19 midis Rexhep Ibishit dhe Gani Rukiqit:



Rexhep: Gani ku je?

Gani: Jam në zyre, e ti?

Rexhep: Unë jam në garazhin tënd. Hej mos e bëjë këtë punë të madhe..., askush nuk duhet të mëson për këtë.

Gani: Jo, jo.

Rexhep: Edhe axha Enver tha po këtë, mirë, pra kur të kthehen ata nga pushimi ti merr atë.

Gani: Pra është njëqind për qind sigurt se është aty.

Rexhep: Po, aty është, ai shkoi ti vërteton emrat edhe njëherë, emri është Nerxhivan, asnjë emër se kush e dorëzoi, ti duhet të din se është dikush nga aty që ta bëri këtë.

Gani: Pra nuk ka pasur emër se kush e dorëzoi, a po?

Rexhep: Jo nuk ka pasur emër, kjo është me qëllim, e kupton, kjo është çka mendojnë. Kjo do të vërtetohet kur e hapin ata kur të kthehen.

Gani: kur jam vetëm me Nexhin dhe Dritën do të të thërrasim për një kafe.

Rexhep: Mirë, pa gajle.

Duke marrë parasysh kontekstin ku është përdorur, Gjykata gjen se referimi "Nexhi" është referimi Nexhivane Dakas derisa referimi "Dritës" është referimi Drita Rukiqit.

Gjatë asaj bisede telefonike i Pandehuri i Parë konfirmoj se rasti i është caktuar të Pandehurit të Tretë.

I Pandehuri i Parë dëshmoi se ai nuk e diskutoi rastin në fjalë me të Pandehurin e Tretë.



I Pandehuri i Dytë, **Gani Grajqevci** dëshmoi. Ai është marr në pyetje si i Dyshuar më 23.05.2008¹⁹.

I Pandehuri i Dytë ka punuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë prej vitit 1972. Në kohën e veprave të pohuara ai ishte Nëpunës i Administratës Civile, përgjegjës për regjistrimin e rasteve civile. Ai dëshmoi se në çfarëdo dite mund të regjistronte prej 5 deri 40 raste. Ai punonte në të njëjtën zyre të Gjykatës së Qarkut si edhe Artifete Krasniqi.

Ndonëse Znj. Krasniqi ishte kryesisht përgjegjëse për regjistrimin e rasteve penale ndonjëherë edhe i Pandehuri i Dytë regjistronte rastet penale.

Gjatë bisedës telefonike më 13.08.2007 në ora 11:00:02 midis Gani Rukiqit dhe Rexhep Ibishit, Zt. Ibishi iu referua takimit me të Pandehurin e Parë dhe të Dytë.

I Pandehuri i Dytë e mohoi se është takuar me të Pandehurin e Parë dhe Rexhep Ibishin.

I Pandehuri i Tretë, **Selman Bogiqi**, dha dëshmi në mbrojtjen e tij. Prokuroria e la në dëshmi Proceverbalin e marrjes së tij në pyetje më 23.07.2008²⁰ dhe 26.02.2009²¹.

I Pandehuri i Tretë dëshmoi se ai ishte gjyqtar për mbi 25 vite.

Prokuroria e la në dëshmi transkriptimin e bisedës telefonike më 13.08.2007 në ora 12:30:41 midis Gani Rukiqit dhe të Pandehurit të Tretë

Gani: Tung

Bogiqi: Tung

Gani: Fal Zotit qenke i sigurt

Bogiqi: Ku je ti, kush të tregoi?

¹⁹ Prova P6

²⁰ Prova P8

²¹ Prova P9



*Gani: Mora informatën, një lloj i problemit, emri im ishte aty, nëse!
Mos të shqetësoj*

Bogiqi: S'ka problem.

Gani: Rasti duket se është me ty. Unë u interesova dhe Shabani më tregoi se pate një aksident trafiku, isha në zyrën tënde e takova punëtorin tënd ai ma dha numrin tënd. Isha në zyrën tënde dhe Agroni dhe djali juaj ma dhanë numrin tënd.

Bogiqi: Pas dy dite do të jem atje dhe pastaj flasim

Gani: Njeri i gjallë interesohet për gjithçka. Selman a është rasti im me ty

Bogiqi: Nuk e di

Gani: I lutem Zotit të jetë me ty, shpresoj nuk është me ndonjë prej kolegëve tu. Sepse nëse është diçka nuk do të brengosësja, të fala nga Drita dhe Nebahate

Duke marrë parasysh kontekstin ku është përdorur, Gjykata gjen se referimi "Dritës" është referimi Drita Rukiqit.

I Pandehuri i Tretë dëshmoi se kjo ishte telefonata e parë që e pranoi nga Gani Rukiqi. Gjatë asaj bisede telefonike Zt. Rukiqi e njoftoi të Pandehurin e Tretë se ai është i përfshirë në një rast i cili ai beson i është caktuar të Pandehurit të Tretë.

Prokuroria e la në dëshmi transkriptimin e bisedës telefonike më 15.08.2007 në ora 2:24:26 midis Gani Rukiqit dhe të Pandehurit të Tretë

Gani: Mirë se erdhe Selman

Bogiqi: Si je Gani...të thirra disa herë sot, por nuk munda të të qasem.

Gani: Isha i zënë te Gazmend Zajm.

Bogiqi: Kontrolllo telefonin nëse do të thirra tri ose katër herë rreth orës 10 ose 12. Çka është problemi?



Gani: Nuk e di po dëgjoj disa raporte penale ndodhen kundër meje, kunatës sime, Dritës dhe Nerxhivane Dakas. Dikush e ka shkruar dhe sipas pohimeve rasti është me ty.

Bogiqi: A është e sigurt se ka ardhur te unë? Antoni më thirri dhe më pyeti për diçka dhe më përmendi këtë, dhe unë i thashë se nëse është me mua atëherë mund të rrinë aty.

Gani: Po, i thashë Rexhës, ti e di se

Bogiqi: Nuk ka nevojë të filtet në telefon... Ganiu tha se është i gëzuar se Selmani shpëtoi pa lëndime nga aksidenti i trafikut.

Duke marrë parasysh kontekstin ku është përdorur, Gjykata gjen se referimi "Dritës" është referimi Drita Rukiqit derisa referimi "Rexhas" është referimi Rexhep Ibishit.

Gjatë asaj bisede telefonike Gani Rukiqi deklaroi se një raport penal është parashtruar kundër tij, Drita Rukiqit dhe Nerxhivane Dakas dhe se rasti i është caktuar të Pandehurit të Tretë. I Pandehuri i Tretë sugjeroi të takohen për kafe.

Prokuroria e la në dëshmi transkriptimin e bisedës telefonike më 16.08.2007 në ora 1:33:34 midis Gani Rukiqit dhe të Pandehurit të Tretë

Gani: Tung Selman, këtu Gani Rukiqi, a je në shtëpi?

Bogiqi: Po, jam,

Gani: Desha të vij të shoh bashkë me Nexhën dhe Dritën, jemi te shkola e Xhemal Mustafës?

Bogiqi: Mirë, hyrja e parë.

Duke marrë parasysh kontekstin ku është përdorur, Gjykata gjen se referimi "Nexhës" është referimi Nerxhivane Dakas derisa referimi "Dritës" është referimi Drita Rukiqit.

Gjatë asaj bisede telefonike i Pandehuri i Tretë u pajtua të takohet me Gani Rukiqin, Drita Rukiqin dhe Nerxhivane Dakas në shtëpinë e tij.



Gjatë marrjes së tij në pyetje më 23.07.2008²² i Pandehuri i Tretë dëshmoi se ai e njihje Gani Rukiqin, Drita Rukiqin dhe Nerxhivane Dakan prej vitit 1985, duke punuar me ta në Komunën e Prishtinës. Në atë kohë i Pandehuri i Tretë ishte Mbikëqyrës për çështje banesore.

Kur ai u morr në pyetje më 23.07.2008, duke i referuar atij takimi, ai dëshmoi

“...ne diskutuam rreth Aktvendimit mbi Nismën e Hetimeve”

Prokuroria e la në dëshmi transkriptimin e bisedës telefonike më 17.08.2007 në ora 10:24:55 midis Gani Rukiqit dhe të Pandehurit të Tretë

Gani: Pyet rreth shëndetit të gjyqtarit dhe familjes, etj.

Bogiqi: E di çka? Zonja është në pushim deri të hënën. A mund të beson? Flamuri shkon te ai të kontrolloj me kë është rasti.

Gani: A të shkoi unë te Flamuri, a po?

Bogiqi: Flamuri do të shkon të kontrolloj të gjen se me kë është rasti. I thashë dje mbrëma të gjen me Ganiun, me atë i cili i regjistron rastet.

Gani: Pra sipas fjalëve të tij rasti është me ty, a po jo?

Bogiqi: Po, mirë,...

Gani: Mirë, sepse jam kah çmendem bashkë me këta kolegë.

Selman: Do të të lajmëroj. Do të shohim.

Duke marrë parasysh kontekstin ku është përdorur, Gjykata gjen se referimi “Flamurit” është referimi Flamur Bogajit derisa referimi “Ganiut” është referimi të Pandehurit të Dytë.

²² Prova P8



Gjatë asaj bisede telefonike i Pandehuri i Tretë deklaroi se ai kishte kërkuar nga djali i tij, Flamur Bogajit, të flet me të Pandehurin e Dytë në mënyrë që vërteton vendin se ku ndodhet rasti.

Prokuroria e la në dëshmi transkriptimin e bisedës telefonike më 19.08.2007 në ora 8:01:20 midis Gani Rukiqit dhe të Pandehurit të Tretë

Gani: Tung, Selman, si jeni, gruaja dhe fëmijët?

Bogiqi: Mirë, nesër, fola pak me Flamurin; ai do të shkon nesër, do ta shikon ...

Gani: A duhet të shkoj të bëjë autorizimin a po jo,

Bogiqi: Po, duhet të shkon nuk shkon kjo pa autorizim.

Gani: Në sa ora duhet të shkoj?

Bogiqi: Rreth orës 8.30.

Gani: Në rregull, unë shkoj në orën 8.30, unë kam takimin gjeneral, çfarë po llogarit?

Bogiqi: Nuk di se çfarë ka brenda, nëse propozohet burgosja ngelet të shihet nga unë. Do ta shikoj dhe do t'ju njoftoj për këtë. Unë jam në pushim dhe do t'ju tregoj.

Gani: Në rregull, ju lutem Selman, ju jeni vëllau im. Shpresoj se nuk do të ndodhë diç e keqe.

Bogiqi: Nesër dëgjohemi dhe pimë kafe.

Gani: Natyrisht, gjithsesi.



Gjatë asaj bisede telefonike i Pandehuri i tretë duke u thirrur në mundësinë e propozimit për burg thotë

“...Ngelet të shihet për mua. Do ta shoh dhe do t’ju njoftoj”

Në atë fazë, i Pandehuri tretë ka qenë mirë i vetdijshëm se ka qenë gjyqtari të cilit i ishte caktuar lënda. Pastaj, i Pandehuri tretë ka propozuar takimin për ditën e nesërme.

Prokuroria ka futur në prova transkriptin e bisedës telefonike të datës 20 gusht 2007-11:46:24 në mes të Gani Rukiqit dhe të Pandehurit të tretë

Gani: Tungjajeta Selman

Bogiqi: Jeni takuar me këtë djalosh?

Gani: Me të kam folur vetëm me telefon. Nuk ju ka ftuar ai?

Bogiqi: Prosesmbajtësi im akoma nuk është kthyer. Ganiu nuk ka mundur ti japë kurrëfarë informacioni.

Gani: A po shkojmë në kafe? Jeni i lirë? Ku jeni

Bogiqi: Jo, Akoma jam këtu i zënë, Ndoshta pasdite mund të dalim.

Gani: Në rregull, kur të jeni i lirë.

Bogiqi: Në rregull, do t’ju bëjë një zile.

Gani: Pra bëjmë atë që tha Flamuri?

Bogiqi: Djaloshi ati i ka thënë se nuk ekziston mundësia për ta parë gëshjen.

Gani: Pra, nuk ka rezik apo?

Bogiqi: Ai nuk e ka parë lëndën. Mos keni merak se do ta amortizojmë.

Duke pasur parasyshë kontekstin në të cilin është përdorur Trupi Gjyqës konstaton se thirrja “Gani” i referohet të Pandehurit të dytë.



Gjatë asaj bisede, i Pandehuri tretë ka sugjeruar takimin më vonë pas dite. Kur Gani Rukiqi ka shfaqur brengën lidhur me gëshijen, i Pandehuri tretë ka thënë:

“Mos u brengos sepse atë do ta amortizojmë”

Gjatë shqyrtimit kryesor i Pandehuri tretë është pyetur se çfarë kishte menduar me përdorimin e tij të fjalës “amortizim”. Ai nuk ka mundur ta sqaronte domethënjen pas përdorimit të tij të fjalës. Ai ka dëshmuar:

“Nuk e di se si më doli kjo fjalë nga goja”

Prokuroria ka futur në prova transkriptin e bisedës telefonike të datës 21 gusht 2007 ora 18:06:40 në mes të të Pandehurit të tretë dhe Gani Rukiqit

Bogiqi: Ajo grua akoma nuk është këthyer, e kam pyetur Flamurin, me rëndësi është se ajo nuk është kthyer akoma. Procesmbajtësja ime më ka thënë se lëndën nuk e kam këtu. Keni dëgjuar diç të re?

Gani: Jo, Nuk kam dëgjuar asgjë. Sot isha i zënë me një bastisje dhe mendoja të të thërrisja më vonë vetëm për t’ju pyetur se si jeni. I kam dhënë Flamurit autorizimin dhe nuk ka nevojë të bëhet ndonjë intervenim tjetër.

Bogiqi: Mund të takohem për një kafe nëse dëshironi.

Gani: Po, por unë nuk jam në Prishtinë.

Sipas kontekstit në të cilin është përdorur, të thirrurit “Flamur” ka të bëjnë me Flamur Bogajn.

Gjatë asaj bisede telefonike, i Pandehuri tretë përsëri propozon tëkim për një kafe.



Prokuroria ka futur në prova transkriptin e bisedës telefonike të datës 21 gusht 2007 në orën 20:57:55 ne mes të Gani Rukiqit dhe të Pandehurit të tretë.

Gani: Tung Selman, çfarë bënë?

Selman: Kush është?

Ganiu : Ganiu, Ganiu.

Selmani: Gani si je?

Gani: Mos po të trazoj?

Selman: Jo, këtu jam me Qazimin, kemi caktuar një takim në Germi me Qazim Qerimin një mik timin.

Ganiu: Në rregull

Selmani: çfarë kemi?

Gani: Jam kthyer. Nuk e di nëse je i lirë të shkojmë për një kafe. Nëse ju konvenon tani mirë nëse jo mund ta lëmë edhe për nesër.

Selmani: Në rregull, ta lëmë për nesër, dëgjohemi nesër

Ganiu: Mirrupafshim.

Selmani: Mirrupafshim.

Ganiu: Mirrupafshim.

Prokuroria ka futur në prova transkriptin e bisedës telefonike të datës 22 gusht 2007 në orën 18:21:04 të bërë në mes të Gani Rukiqit dhe të Pandehurit të tretë

Ganiu: Tung Selman, mos po pushon?

Bogiqi: Kam ca mysafirë.



Ganiu: Kemi një kushëri me diabet, më thanë se nuk është mirë.

Bogiqi: Le të takohemi në orën shtatë pa një qerek në Shark.

Ganiu: Në regull.

Gjatë asaj bisede telefonike, i Pandehuri i tretë ka propozuar që të takoheshin në orën 6.45 pasdite në 'Shark'.

Prokuroria ka futur në prova transkriptin e bisedës telefonike të bërë më 22 gusht 2007 në orën 20:05:52 në mes të Gani Rukiqit dhe Nerxhivane Daka-s

Ganiu: Ku je ti, vajza ime?

Nerxhivane: Doja ta ndalja lavatrigen.

Ganiu: Sapo u ndava me Selmanin.

Nerxhivane: A mos je hidhëruar?


Ganiu: Jo, fare. Po më shoqëron për një kafe në Interminex, po e thërras edhe Dritën për t'na bërë shoqëri?

Nerxhivane: Po.

Sipas kontekstit në të cilin është përdorur, Gjykata ka konstatuar se të thirrurit "Drita" ka të bëjnë me Drita Rukiqin.

Gjatë asaj bisede telefonike Gani Rukiqi është thirrur në një takim nga i cili sapo ishte larguar me të Pandehurin e tretë. Kjo pason nga biseda me të Pandehurin e tretë në orën 18:21:04 se takimi të cilit i referohet Gani Rukiqi ishte takimi në Shark. Gani Rukiqi u pajtua me Nerxhivane Dakën që të takoheshin në Interminex. Ai më tutje theksoi se do të kërkonte nga Drita Rukiqi që tu bashkohej atyre.

Prokuroria ka futur në prova transkriptin e një bisede telefonike të bërë më 24 gusht 2007 në orën 16:43:15 në mes të Gani Rukiqit dhe të Pandehurit të tretë



Bogiqi: Dje këtu ishte referenti im dhe më tha se nuk e kishte me vete. Gani, Nuk di asgjë deri të hënën.

Ganiu: Në rregull.

Bogiqi: E kam pyetur në detaje, ajo ka thënë se kjo nuk është regjistruar te ne. Më kryesorja vie të hënën.

Ganiu: Pse ka thënë Gani, atëherë?

Bogiqi: Është shumë interesant.

Ganiu: Është interesant. Nuk di më shumë detaje.

Bogiqi: Edhe Shefi ynë i madh më ka ftuar dje, për t'më pyetur nëse keni ndërmarrë ndonjë veprim. I kam thënë se nuk kemi bërë asnjë veprim.

Ganiu: Kam frikë se dikush mund të veprojë pa u kthyer ju.

Bogiqi: Jo, për derisa të mos e caktojnë dikë tjetër...

Ganiu: Do të shkoni në punë të hënën?


Bogiqi: Jo, Gani, të shtunën, e kam ndërmend të kthehem në punë, pasnesër do të shkoj në grykën e Rugovës, më duhet të shkoj atje, sepse gruaja më është shumë anemike. Këtë do ta shikojë Flamuri ditën e hënë. Nëse Antoni nuk mund ta marrë atë atëherë askush tjetër nuk do të mundet. Mos ke frikë.

Ganiu: Në rregull,

Bogiqi: Jemi në një vend të papërshtatshëm. Faleminderit që keni ngritur këtë gëshje.

Gani: Faleminderit që keni ngritur këtë gëshje, Ju lutem më besoni se unë po ju thërras vetëm për të mësuar lidhur me shëndetin tuaj; Është me rëndësi që ju dhe bashkëshortja juaj jeni mirë me shëndet.

Sipas kontekstit në të cilin është përdorur, Gjykata gjenë se përmendja e emrit "Flamur" i referohet Flamur Bogajt gjersa ajo "Antoni" Anton Nokajt, Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.



Prokuroria e ka futur në prova transkriptin e bisedës telefonike të datës 3 shtator 2007 ora 5:05:04 në mes të Gani Rukiqit dhe të Pandehurit të tretë

Gani: Tungjatjeta Selman, Mos poju mërzis?

Bogiqi: Vazhdo.

Gani: Si shkoi në Gillogovc?

Bogiqi: Mirë

Gani: A po takohemi nesër?

Bogiqi: Në rregull, ose më vonë kurdo që të duash, është në rregull.

Gani: Nuk jamë shumë i sigurtë për më vonë sepse e kam atë nipin e sëmurë në Gillogovc. Nëse kthehem nga Gillogovci do t'ju bëjë një zile.

Bogiqi: Në rregull, Sot kam ca obligime por e lëmë për nesër.

Gani: Më vie mirë që nuk do të ketë telashe për juve.

Bogiqi: Jo, jo... E shikova sot në mëngjes. Është shumë mirë, mos ke merak.

Gani: Në rregull, faleminderit.

Gjatë asaj bisede telefonike i Pandehuri i tretë është pajtuar për tu takuar me Gani Rukiqin. Ai tha se e kishite shikuar dosjen e lëndës dhe i tha ati të mos bëhej merak.

I Pandehuri i tretë ka dëshmuar para këtij Trupi gjyqës se ai e kishite takuar Gani Rukiqin në zyrën e tij në Gjykatën e Qarkut. Ai takim kishite ndodhur më 3 shtator 2007. Ai tha se kjo ishte hera e parë që e kishite parë dosjen. I Pandehur i tretë ka dëshmuar se dosja e lëndës përmbante vetëm aktvendimin mbi iniciativën hetimëve. Ai tha se nuk ekzistonte asnjë kërkesë nga ana e



prokurorisë se të dyshuarit nuk do duhej të kishin më tujte qasje në dosje, ai kishte pohuar se dosja nuk ishte e shënuar si "konfidenciale". Ai dëshmoi se nuk e kishte vërejtur se kjo ishte një "SEC" dosje.

I Pandehuri i tretë kishte dëshmuar se gjatë atij takimi, ai e kishte informuar z. Rukiqi se kundër tij ishte inicuar një hetuesi nën akuzën për dy vepra penale dhe se pesoni i cili e kishte dhënë informacionin ishte Agim Kreziu.

Prokuroria e ka futur në prova transkriptin e bisedës telefonike të datës 3 shtator 2007 në ora 12:44:31 në mes të Gani Rukiqit dhe Nebahate Jasharit

Gani: A nuk mundem të flasë prap?

Nebahate: Tungjatjeta. Ku jeni tani?

Gani: Desha t'ju them diç, por mos i thuaj askujt, tani për tani, më dëgjoni?

Nebahate: Po.

Gani: Ai qen e ka dërguar atë. Agim Kryeziu e kishte dërguar atë në gjyq, Unë nuk i kam thënë askujt, as Florës, as Dritës dhe as Nexhit, i pari jeni ju që ju kam thënë. Ma bërë një zile kur të jeni i lirë?

Nebahate: Në rregull.

Sipas kontekstit në të cilin është thënë Gjykata gjenë se emri "Drita" i referohet Drita Rukiqit gjersa ajo "Nexh" Nerxhivane Dakaës

Kjo bisedë telefonike është bërë pas takimit në Gjykatën e Qarkut në mes të Gani Rukiqit dhe të Pandehurit të tretë.

Duke iu referuar informacionit të cilin ai i dha Gani Rukiqit, i Pandehuri i tretë ka dëshmuar para kësaj gjykate se ai kishte një obligim ligjor për ta siguruar atë informacion. Në mbështetje të këtij pohimi, ai i referohet dispozitave të Nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale



Gjykata ka obligim për ta informuar të pandehurin apo cilëndo palë tjetër në procedurë për të drejtën e tij që ka ai person sipas Kodit të tanishëm si dhe për pasojat e dështimit për të vepruar, Nëse ai person mund ta lëshojë ndonjë veprim në procedurë si pasojë e mos djesh apo për të njejtën arsye nuk e ushtron të drejtën e tij/saj.

Ky është një pohim absurd. Që një i pandehur të informohet për të drejtat e tij gjatë procedurës penale është një gjë. Ti ofrosh informacionin mbi rjedhën e hetimeve një të dyshuari është krejt tjetër gjë.

I Pandehuri i tretë ka dëshmuar se nuk kishte diskutuar për çështjen me të Pandehurin e parë.

I Pandehuri i tretë ka dëshmuar për një kërkesë të cilën ai ia kishte bërë Gani Rukiqit për ndihmë lidhur me një garazhë në lagjen Ulpiana. Gjatë marrjes së tij në pyetje, më 26 shkurt 2009²³ i Pandehuri i tretë ka dëshmuar “garazhda është e djallit të vëllaut tim Arban Fetahu”. I Pandehuri i tretë nuk e ka mohuar faktin se e kishte kërkuar ndihmën e z. Rukiqi. Ai ka dëshmuar se ata e njihnin njëri tjetrin për disa vite meqë më parë kishin punuar së bashku në Komunë.

Prokuroria e ka futur në prova transkriptin e përgjimit të komunikimeve telefonike në mes të të Pandehurit të tretë dhe Gani Rukiqi lidhur me atë çështje. Një aso komunikimi kishte ndodhur në prill të vitit 2008. Mirëpo, në mars të vitit 2008 kishenjë komunikim telefonik në mes tyre përkitazi me një takim. Tema e takimit nuk ishte përmendur.

Sipas transkriptëve të bisedave telefonike, biseda e parë ka ndodhur disa muaj pas bisedës së tyre lidhur me hetimet kundër Gani Rukiqit. Para gjyqit nuk është dhënë asnjë provë se në kohën kur i Pandehuri i tretë e ka njohtuar Gani Rukiqin për akuzat kundër tij, ai e kishte pasur qëllimin për ta fituar një benefit të kundërligjshëm për veten e tij, një tjetër person apo një organizatë afariste apo se kishte pasur për qëllim ti shkaktonte dëm një personi apo një organizatë tjetër.



I Pandehuri i parë The First Defendant gjatë tërë kohës ka qenë arkatar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Ai ishte një shërbyes civil i cili kryente detyra zyrtare dhe kishte marrë besimin e institucioneve publike. Si i tillë, i akuzuari i parë ishte një “person zyrtar” në kuptim të Nenit 347 të KPK-së.

I Pandehuri i tretë, Selman Bogiqi

I Pandehuri i tretë gjatë tërë kohës ka qenë gjyqtar i Gjykatës së Qarkut Prishtinë. Ai ishte një shërbyes civil i cili kryente detyrën zyrtare dha ka marrë besimin brenda institucionit publik. Si i tillë i Pandehuri i tretë ishte një “person zyrtar” në kuptim të Nenit 347 të KPK-së.

ii. **Nëse Dëshmitari i Parë dhe i tretë kanë komunikuar, dërguar apo në ndonjë mënyrë i kanë dhënë informacionin apo dokumentacionin një personi tjetër?**

I Pandehuri i parë Enver Zhita

I Pandehuri i parë ka dëshmuar se ai e ka informuar Rexhep Ibishin lidhur me hetimet kundër Gani Rukiqit. Atij nuk i kujtohej nëse kishte përmendur emrat e të dyshuarve të tjerë. Ai tha se informacioni të cilin ia kishte zbuluar z. Ibishi ishte kufizuar në informacionin që gjendet në regjistrin PPH.

Nga transkripti i përgjimeve të komunikimit telefonik të datës 13 gusht 2007 ora 10:40:36 në mes të Gani Rukiqit dhe Rexhep Ibishit se z. Ibishi ishte me të Pandehurin e parë z. Ibishi thotë “Po shikoj”. Ai i referohet Regjistrit PPH.

Më 13 gusht 2007 në orën 10:48:02, Rexhep Ibishi ka folur përsëri në telefon me Gani Rukiqin. Gjatë asaj bisede, z. Ibishi e ka informuar Gani Rukiqin se kundër tij, Drita Rukiqit dhe Nerxhivane Dakës ishte inicuar një hetuesi.

Gani Rukiqi e kishte pyetur z. Ibishi nëse e kishte parë “një kopje”. Sipas të gjitha ghasave kjo i referohet dosjes që permbante aktivndimit mbi fillimin e hetimeve. Në përgjigjen e tij z. Ibishi kishte thënë:

“Jo kopjen por librin në të cilin kjo është shënuar”



Mr. Ibishi theksoi më tutje

*“aty thuhet Gani Rukiqi, Drita Rukiqi Nerxhivane Daka ata kanë
kërkuar rryshfet nga dikush që i kishite thirrë për kafe për të
biseduar me të dhe për ta marrë rryshfetin, nuk ishte përmendur as
shuma e parave dhe as ndonjë gjë tjetër”*

Duket se ky koment bazohet në mbi supozim, referencën e dhënë në Regjistrin PPH për veprat nën nenet 339²⁴ dhe 343²⁵ të Kodit Penal të Kosovës.

Para trupit gjykues nuk është dhënë asnjë provë. I Pandehuri i parë në të vërtetë ka zbuluar informacionin dhe veç kësaj ai gjindet në Regjistrin PPH.

I Pandehuri i tretë, Selman Bogiqi


I Pandehuri i tretë është takuar me Gani Rukiqin me 16 Gusht, 22 Gusht dhe me 3 Shtator 2007. Gjate marrjes se tije ne pyetje me 23 Maj 2008 i pandehuri i trete e pranoi qe ne takimin e 16 Gushtit 2007 ata kishin biseduar rreth aktvendimit mbi iniciimin e hetimeve. I pandehuri i trete ka deshmuar prane kesaj Gjykate qe ne Shtator te vitit 2007 ai e takoi Gani Rukiqin ne zyren e tij ne Gjykaten e Qarkut dhe se gjate atij takimi ai i tregoi Gani Rukiqit permbajtjen e hetimeve dhe emrin e informuesit.

iii. Nëse informacioni apo dokumentacioni ishin zbuluar në mënyrë të duhur një “Sekret zyrtar” në kuptim të Nenit 347 të KPK-së?

Informacioni apo dokumentacioni të përfshihen në klasifikimin e një “Sekreti zyrtar” duhet të proklamohet si i tillë me ligj, me dispozita tjera apo me një vendim të vet autoritetit kompetent të lëshuar sipas ligjit, për të qenë një sekret zyrtar.

²⁴ Article 339 - Abusing Official Position or Authority

²⁵ Article 343 - Accepting bribes



Ishte gëshjtje e prokurorisë ai informacion apo dokumentacion në dosjen gjyqsore e shënuar se një gëshjtje "SEC" është një 'sekret zyrtar' në kuptim të Nenit 347 të KPK-së.

Atifele Krasniqi ka dëshmuar se më 3 gusht 2007 ajo kishte pranuar aktivndimin mbi iniciimin e hetimeve në gëshhtjen SEK numër 58/07. Ajo kishte regjistruar lëndën në regjistrin PPH. Gëshhtja në regjistrin PPH përbënë, mes tjerash, emrat e të pandehurve dhe të veprave për të cilat ata dyshohen.

Informacioni i zbuluar nga i Pandehuri i parë është kufizuar në informacionin e përfshirë në Regjistrin PPH.

Ndonëse gëshhtja në Regjistrin PPH i është referuar asaj si një SEK gëshhtje Regjistri PPH nuk ishte një 'zbulim zyrtar' në kuptim të Nenit 347 të KPK-së. Asnjë ligji, dispozitë apo vendim tjetër i organit kompetent, i lëshuar sipas ligjit, e kishte përshkruar informacionin i cili gjendet në Regjistrin PPH për të qenë 'Sekret zyrtar'.

Mirëpo nëse gëshhtjet SEK janë sekrete Zyrtare në kuptim të nenit 347 kjo do të mund të ishte argumentuar se informacioni i cili ka të bëjë me gëshhtje të tilla mbajnë ndonjë karakteristikë përkundër regjistrimit të tyre në mënyrë të gabuar.

Prokurori është pajtuar se nuk ishte në dijeni për ndonjë ligji, dispozitë apo ndonjë vendim të lëshuar nga vet organi kompetent në bazë të ligjit i cili proklamon se 'SEK' gëshhtjet janë sekrete zyrtare në kuptim të Nenit 347 të KPK-së.

Gjykata gjenë se asnjë ligji, dispozitë apo vendim i lëshuar sipas ligjit nga vet organi kompetent nuk thotë se lëndët SEK, informacioni apo dokumentacioni i cili gjendet në dosjen e lëndës, janë të emruara si të tilla, si sekrete zyrtare në kuptim të Nenit 347 të KPK-së.

Në këto rrethana Trupi Gjykses gjenë se 'SEK' lëndët nuk janë sekrete zyrtare në kuptim të Nenit 347 të KPK-së.

Duke përcaktuar se 'SEK' gëshhtjet nuk janë 'sekrete zyrtare' në kuptim të Nenit 347 të KPK-së. Është e panevojshme të shqyrtohet nëse zbulimi nga ana e të pandehurve të informacionit apo dokumentacionit të përmendur ka shkakuar apo mund të kishte shkakuar pasqarë të




dëmshme dhe nëse të pandehurit ishin të autorizuar për zbulimin e informacionit apo dokumentacionit.

Për arsytet e cekura, unë nxjerrë këtë Aktgjykim.

Më 16 tetor 2009.

Gjyqtari Malcolm Simmons
Kryetar i Trupit Gjykuës



Procesmbajtës

KËSHILLË JURIDIKE: Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë kundër këtij Aktgjykimi brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së kopjes së të njëjtit.